



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.217-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, të parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Junik, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.217/2025, e datës 14.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Junik, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.217/2025, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në të cilën pretendohet se ka dyshime të bazuara në prova për manipulim përgjatë procesit zgjedhor në Komunën e Junikut, konkretisht rritje e pazakontë e numrit të votuesve brenda vetëm dy muajve të fundit deri në shtator, në mënyrë të papërrputhme me trendin e viteve të kaluara dhe me numrin real të banorëve rezidentë në komunë, përfshirje në listat e votuesve e personave me mbiemra që nuk ekzistojnë në asnjë familje apo lagje të njohur në Junik, shtim i votuesve që nuk jetojnë, nuk banojnë dhe nuk kanë asnjë lidhje faktike me territorin e komunës, përfshirë mungesën shtëpive, banesave apo qirave në Junik, vendeve të punës apo bizneseve aktive në këtë komunë, dëshmi të shërbimeve komunale, dhe çdo pasurie tjetër të patundshme.

Tutje parashtruesi i ankesës thekson se këta persona jetojnë, punojnë dhe kanë familjet e tyre aktualisht në adresat e mëparshme, përpara bartjes artificiale të vendbanimit në Junik për qëllime votimi, dhe kjo gjendje është lehtësisht e verifikueshme nga institucionet përkatëse, përmes regjistrave civilë dhe evidencave tatimore, si dhe përmes dëshmive nga komuniteti

lokal. Po ashtu në ankese si shkelje theksohen pjesëmarrja në votim e personave të panjohur, të cilët nuk janë njohur as nga komisionerët e qendrave të votimit e as nga vëzhguesit e partive politike, raportime të shumta nga qytetarët për praninë e personave të panjohur në qendrat e votimit gjatë ditës së zgjedhjeve, prania e automjeteve me targa nga të gjitha rajonet e Kosovës, që vërteton sjelljen e organizuar të votuesve jo rezidentë, dalja masive e votuesve, jo rezidentë në orët e fundit në mbledhje për t'u mos identifikuar se janë votues të ardhur enkas për të votuar Kryetarin R. Shehu, operimi i organizuar në ndërrimin e adresave-vendbanimit në Qendrën për pajisje me dokumente personale në Junik nga vajza dhe dhëndëri i kryetarit R. Shehu dhe në zyrën e gjendjes civile dhe drejtorinë e kadastrit në komunën e Junikut me militantë partiakë të tij, të cilët kanë pasur qasje të drejtpërdrejtë në proceset e regjistrimit civil dhe potencialisht në manipulimin e të dhënave të votuesve.

Tutje parashtuesi thekson se Juniku e ka vetëm një qendër votimi, ku historikisht qytetarët nuk kanë pasur problem për të gjetur vendvotimin apo nuk u është ndërruar vendvotimi, pra nuk ka se si ti ndërrohet dikujt qendra e votimit në Junik sepse është vetëm një qendër, mirëpo ky ndryshim rritje e numrit të votuesve me mbiemra që nuk egzistojnë në Junik.

Në përgjigje në ankese të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) theksohet se KQZ, bazuar në nenin 8 paragrafi 1, dhe 2, nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228 Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, bëhet procesi i krijimi të Listës së Votuesve në Republikën e Kosovës,

Bazuar në dispozitat e mësipërme, KQZ ju njofton se Lista e votuesve përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe Qendrën e Votimit në të cilën votuesi është caktuar për të votuar. Ndërrimi i Qendrës së Votimit bazohet në përditësimet e sakta të Regjistrimit Qendror Civil, andaj çdo ndryshim i Qendrës së Votimit, ka ardhur si rezultat i të dhënave të përditësuara të Regjistrimit Qendror Civil.

Përveç të lartcekurave, KQZ vazhdimisht ka bërë fushatë informuese, përmes mediave, rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin e Qendrës së Votimit për votuesit e Republikës së Kosovës, dhe qytetarët kanë pasur të drejtën e ndërrimit të Qendrës së Votimit deri më datën 29.08.2025. Prandaj, pala ankuese është dashur që pretendimet e saj t'i paraqesë gjatë periudhës dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar më datën 5 shtator 2025. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar Listën Votuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës më datën 6 shtator 2025, pas përfundimit të afatit ligjor për ankese.

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin ZL.A.nr.217/2025 të datës 15.10.2025, ka hedhur të palejuar ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.92/2025 të datës 20.10.2021, ka aprovuar ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

(AAK), me seli në Junik, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.217/2025 të datës 15.10.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktvendimin A.A.nr.92/2025 të datës 20.10.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rivendosjes, Paneli i mbledhur, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga teresia e shkresave, provave dhe deshmive është konkluduar se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, vlerësoi se janë të pambështetura dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se ka pasur manipulim përgjatë procesit zgjedhor në Komunën e Junikut, konkretisht gjatë ditës së votimit.

Neni 119 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*.

Pretendimet që ndërlidhen me rritjen e papritur të numrit të votuesve, përfshirjen e personave të panjohur në listat zgjedhore dhe në procesin e votimit, si dhe veprime të organizuara nga persona të lidhur me strukturat komunale, tani për tani mbeten vetëm në suaza të supozimit nga se nuk janë faktuar apo të dokumentuara me asnjë dëshmi materiale – prove shkresore apo dokumentacion zyrtar nga institucionet kompetente, dhe në mungesë të provave paneli vlerëson se pretendimet e ngritura nuk përmbushin standardin ligjor për të konstatuar parregullsi që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor, andaj si rrjedhojë ankesa refuzohet si e pabazuar.

Keshtu që duke u nisur nga kjo gjendje e fakteve, paneli pas shqyrtimit të përmbajtjes së ankesës dhe pretendimeve të parashtruara në të, vlerëson se ankesa nuk është e mbështetur me prova konkrete, të verifikueshme dhe ligjërisht të pranueshme që do të arsyetonin bazë të artikulueshme për ndërmarrjen e veprimeve juridike ndaj procesit zgjedhor të zhvilluar në Komunën e Junikut.

Prandaj duke marrë parasysh të cekurat si me larte, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 dhe 119.1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.217-2/2025 i datës 24.10.2025

Kryesueset e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.100/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Muhamet Rexha dhe Milena Deric anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.217-2/2025, të datës 24.10.2025, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e mbajtur më datë 29.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e subjektit politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.217-2/2025, të datës 24.10.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.217-2/2025, të datës 24.10.2025, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa ZL.A.nr.217/2025, e datës 14.10.2025, e paraqitur nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Junik, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 tetor 2025.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të: Aprovojë ankesën si të bazuar, të ndryshoj



vendimin e PZAP-së ZL.Anr.217-2/2025, të datës 24.10.2025, apo i njëjti të prishet, të anulohen dhe të shpallen të paligjshme zgjedhjet komunale të 12 Tetorit 2025 në Komunën e Junikut, të urdhërohet KQZ që të bëjë pastrimin e listave dhe largimin e të gjithë atyre votuesve të cilët regjistruar si banorë-votues të Junikut në tre muajt e fundit para zgjedhjeve të 12 Tetorit 2025, dhe që Komuna e Junikut të shkoj në rivotim.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ankesën e datës 27.10.2025, të parashtruar nga ankuesi subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, të refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të PZAP ZL.Anr.217-2/2025, të datës 24.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.A.nr.217/2025 nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në të cilën pretendohet se ka dyshime të bazuara në prova për manipulim gjatë procesit zgjedhor në Komunën e Junikut, konkretisht rritje e pazakontë e numrit të votuesve brenda vetëm dy muajve të fundit deri në shtator, në mënyrë të papërpunueshme me trendin e viteve të kaluara dhe me numrin real të banorëve rezidentë në komunë.

Ankuesi pretendon për përfshirje në listat e votuesve të personave me mbiemra që nuk ekzistojnë në asnjë familje apo lagje të njohur në Junik; shtim të votuesve që nuk jetojnë, nuk banojnë dhe nuk kanë asnjë lidhje faktike me territorin e komunës; mungesë të shtëpive, banesave apo qirave në Junik; mungesë vendesh pune apo biznesesh aktive në këtë komunë, dëshmi të shërbimeve komunale dhe çdo pasurie tjetër të patundshme. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se këta persona jetojnë, punojnë dhe kanë familjet e tyre aktualisht në adresat e mëparshme, para bartjes artificiale të vendbanimit në Junik për qëllime votimi, dhe kjo gjendje është lehtësisht e verifikueshme nga institucionet përkatëse përmes regjistrave civilë dhe evidencave tatimore, si dhe përmes dëshmive nga komuniteti lokal.



Po ashtu, në ankesë si shkelje theksohet pjesëmarrja në votim e personave të panjohur, të cilët nuk janë njohur as nga komisionerët e qendrave të votimit e as nga vëzhguesit e partive politike; raportime të shumta nga qytetarët për praninë e personave të panjohur në qendrat e votimit gjatë ditës së zgjedhjeve; prania e automjeteve me targa nga të gjitha rajonet e Kosovës, që vërteton sjelljen e organizuar të votuesve jorezidentë; dalja masive e votuesve jorezidentë në orët e fundit të mbrëmjes për të mos u identifikuar se janë votues të ardhur enkas për të votuar kryetarin R. Shehu; operimi i organizuar në ndërrimin e adresave-vendbanimeve në Qendrën për pajisje me dokumente personale në Junik nga vajza dhe dhëndri i kryetarit R. Shehu dhe në zyrën e gjendjes civile dhe drejtorinë e kadastrit në komunën e Junikut me militantë partiakë të tij, të cilët kanë pasur qasje të drejtpërdrejtë në proceset e regjistrimit civil dhe potencialisht në manipulimin e të dhënave të votuesve.

Tutje, parashtruesi thekson se Juniku ka vetëm një qendër votimi, ku historikisht qytetarët nuk kanë pasur problem për të gjetur vendvotimin apo nuk u është ndryshuar vendvotimi, pra nuk ka se si t'i ndryshohet dikujt qendra e votimit në Junik, sepse është vetëm një qendër. Megjithatë, ka ndodhur një rritje e numrit të votuesve me mbiemra që nuk ekzistojnë në Junik.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: KQZ, bazuar në nenin 8 paragrafët 1 dhe 2, nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 "Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve", si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024", ka zhvilluar procesin e krijimit të Listës së Votuesve në Republikën e Kosovës.

Bazuar në këto dispozita, KQZ njofton se Lista e Votuesve përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe qendrën e votimit në të cilën votuesi është caktuar për të votuar. Ndërrimi i qendrës së votimit bazohet në përditësimet e sakta të Regjistrit Qendror Civil, andaj çdo ndryshim i qendrës së votimit ka ardhur si rezultat i të dhënave të përditësuara të këtij regjistri. Përveç këtyre, KQZ ka zhvilluar fushata informuese përmes mediave, rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin e qendrës së votimit për votuesit e Republikës së Kosovës. Qytetarët kanë pasur të drejtën e ndërrimit të qendrës së votimit deri më datë 29.08.2025. Prandaj, pala ankuese është dashur që pretendimet e saj t'i paraqesë gjatë periudhës dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar më datë 5 shtator 2025. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se KQZ ka certifikuar



Listën Votuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës më datë 6 shtator 2025, pas përfundimit të afatit ligjor për ankesa.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartpërmendur të subjektit politik AAK, me seli në Junik, dhe duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktvendimin A.A.nr.92/2025, të datës 20.10.2025, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), refuzoi në tërësi të pabazuar ankesën e paraqitur ZL.A.nr.217/2025, të datës 14.10.2025.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik AAK, me seli në Junik, janë të pambështetura dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur të vërtetohet se ka pasur manipulim gjatë procesit zgjedhor në Komunën e Junikut, konkretisht gjatë ditës së votimit. Neni 119 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj.”*

Pretendimet që ndërlidhen me rritjen e papritur të numrit të votuesve, përfshirjen e personave të panjohur në listat zgjedhore dhe në procesin e votimit, si dhe veprimet e organizuara nga persona të lidhur me strukturat komunale, për momentin mbeten vetëm në suaza të supozimit, pasi nuk janë faktuar apo dokumentuar me asnjë dëshmi materiale, provë shkresore apo dokumentacion zyrtar nga institucionet kompetente. Në mungesë të provave, Paneli vlerëson se pretendimet e ngritura nuk përmbushin standardin ligjor për të konstatuar parregullsi që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor, andaj, si rrjedhojë, ankesa refuzohet si e pabazuar. Duke u nisur nga kjo gjendje e fakteve, Paneli, pas shqyrtimit të përmbajtjes së ankesës dhe pretendimeve të parashtruara në të, vlerëson se ankesa nuk është e mbështetur me prova konkrete, të verifikueshme dhe ligjërish të pranueshme që do të arsyetonin bazë të artikulueshme për ndërmarrjen e veprimeve juridike ndaj procesit zgjedhor të zhvilluar në Komunën e Junikut.



Prandaj, duke marrë parasysh të cekurat si më lart, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës, në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse, në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, nën të cilin përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* Nga arsyet e theksuara më lartë, dhe në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 dhe 119 par.1 të LZP-së, dhe mbi këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 14.10.2025, të parashtruar nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, lidhur me pretendimet për parregullsi në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12.10.2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Sipas nenit 23 dhe 28 të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, gjykata vlerësoi se drejtë janë zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejnë edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtuesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe veçanërisht vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me rritjen e listës së votuesve, si dhe provave materiale: fotografi të parcelave, ngastrave kadastrale, shtëpive, të parashtruara nga ankuesi për të faktuar *“aspektin”* e vendbanimit apo vendqëndrimit të personave që kanë votuar, vlerësoj se të njëjtat janë pretendime irelevante, pasi që edhe sikur të qëndronin si të tilla në këtë fazë të procedurës nuk mund të shqyrtohen e as të jenë objekt shqyrtimi sepse PZAP-i në këtë fazë të procedurës nuk mund të shqyrton listën e votuesve, e cila listë është certifikuar me datë 06 shtator 2025 pas përfundimit të afatit për ankesë lidhur me këtë listë të njëjtën mundësi e kanë pasur të gjitha subjektet politike ta kundërshtojnë brenda afateve duke



përfshirë edhe subjektin ankues, por jo tani në fazën e shqyrtimit të ankesës që i referohet parregullsive në ditën e votimit. Të gjithë personat që janë të përfshirë në listë të votuesve “*me apo pa të drejtë me qenë pjesë e listës*” kanë të drejtën e votës përderisa gjenden në listën e votuesve dhe askush nuk mundet të ua ndalon, përderisa lista si e tillë nuk është atakuar asnjëherë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sa i përket pretendimeve tjera për parregulsi të njëjtat nuk kanë mundur të provohen as para PZAP-it e as para Gjykatës Supreme. Ndërsa, sa i përket provave të dorëzuara nga ankuesi, nga të cilat pretendohet për regjistrime të jashtëligjshme të votuesve në Komunën e Junikut, kolegji vlerëson se ajo që është thënë më lartë vlejnjë në raport me këto pretendime se në këtë fazë të procedurës nuk i shqyrton përfshirjen me apo të drejtë në listë të votuesve personave të caktuar.

Në referim të nenit 8 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, [Lista e votuesve], ku përcaktohet se: “1. KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrimit Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia”, si dhe nenit 83 [Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit], ku përcaktohet se: “2. Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.”, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se nga ana e ankuesit - subjektit politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk është provuar me asnjë provë bindëse se ka pasur rritje të pazakontë të numrit të votuesve, apo përfshirje të personave të panjohur për komunitetin lokal në ditën e zgjedhjeve, sipas listës votuese, të cilat do të binin ndesh me dispozitat e lartpërmendura. Për më tepër, lista e votuesve është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe, si e tillë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi pas përfundimit të afatit ligjor për ankesa mbi listën votuese.

Në pajtim me nenin 64 paragraf 2, nënparagraf 2.7 dhe 95 par.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr.03/2024, për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës Votuese, përgjegjësia për saktësinë e listës së votuesve bie mbi KQZ-në, ndërsa çdo kontestim ndaj saj duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar, përndryshe çështja nuk mund të shqyrtohet në këtë fazë të procesit zgjedhor. Duke qenë se ankuesi nuk ka dëshmuar asnjë fakt konkret që të vërtetojë ndikimin



real në rezultatin zgjedhor dhe për shkak se lista e votuesve është dokument përfundimtar dhe i pakontestueshëm pas certifikimit nga KQZ, kolegji arriti në përfundimin se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj.

Ndërsa, sipas nenit 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, me të cilin riformulohet neni 6 i saj, është përcaktuar se: *“Periudha kundërshtimit dhe konfirmimit fillon, jo më vonë se pesë (5) ditë pas publikimit të listës preliminare të votuesve dhe përfundon, jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të periudhës për ndërrimin e QV”*, që si rrjedhojë ankesa për listën votuese është dashur të paraqitet përpara certifikimit të saj më datë 6 shtator 2025.

Ankuesi, me pretendimet ankimore, me asnjë provë nuk ka arritur që të vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë nga ana e organit vendimi i të cilit është kontestuar, andaj si të pathemelta i ka vlerësuar pretendimet e ankuesit në ankesë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Lista e votuesve dhe ndryshimi i të njëjtës është i lidhur ngushtë me listën e vendbanimit që është kompetencë e zyrës për regjistrin civil, ndërsa në momentin që ndryshohet vendbanimi secilit person i ndryshohet edhe vendvotimi por edhe qyteti ku mund të votojë. Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në mënyrë të kundërligjshme janë lejuar ndryshimet e vendbanimeve mund edhe të qëndrojnë por nuk mundën me qenë objekt shqyrtimi nga PZAP-i e as Gjykata Supreme, pasi nëse rezulton se kjo është bërë sikurse pretendonhet mundet me qenë objekt shqyrtimi i Prokurorisë për hetim të mundshëm në drejtim të elementeve të veprës përkatëse penale, por jo si parregullsi që lidhet me ditën e votimit. Pra ankuesi parregullsitë i lidhë me ditën e votimit por që nuk ka arritur të provojë asnjë parregullsi konkrete në ditën e votimit, se kanë votuar persona që nuk kanë qenë pjesë e listës së votuesve, se kanë votuar persona pa të drejtë, se ka pasur presion në drejtim të votuesve se ka pasur ndërhyrje në vullnetin e lirë të votuesve se ka pasur cenim të së drejtës së votës si dhe parregullsi të tjera që i referohen ditës së votimit, ato që janë dorëzuar si prova i referohen asaj që është thënë më lartë e që në asnjë mënyrë nuk mundet me qenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë e aq më pak në këtë fazë të procesit zgjedhor.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS


AA.nr.100/2025 me datë 29.10.2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik




GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNIKA ZA LICNO DOSTAVLANJE

Sheji i shkresës AA-100/2025
Oznaka spisa:

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsesës, fqiu, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, susedu lica zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

(Të panevojshmeve tjeri vizë - nepotrebne pečrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVUKI
29. 10. 2025

Numri i shtojcave: 2
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

29. 10. 2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

1.54 14.23

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktin pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač. Napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Em 1206